



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.342/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lorik Rashiti, kandidat për Kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 27.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

HEDHET e pasafatshshme, ankesa ZL.Anr.342/2025 e datës 24.10.2025, e parashtruar nga Lorik Rashiti, kandidat për Kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 24.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Lorik Rashiti, kandidat për Kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, në të cilën thekson se duke u bazuar në të drejtën tonë ligjore për të paraqitur ankesa pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, parashtrojë këtë ankesë lidhur me një parregullsi të evidentuar gjatë procesit të numërimit të votave në QKN-Podujevë në zgjedhjet lokale që u mbajtën në Komunën e Podujevës, ku pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në QKN-Podujevë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave nuk figurojnë në Vendvotimet përkatëse. Këto vendvotime lidhen kryesisht me votues që i takojnë raporteve familjar e po ashtu edhe konstatime të vëzhguesve nga vendvotimet që kanë pohuar se kanë vërejtur numër më të madh të votave për mua gjatë numërimit të fletëvotimeve për Kuvendin Komunal — Podujevë. Parashtruesi i ankesës thekson se vendvotimet që unë kam hasur një gjë të tillë të dyshimtë janë: 1812 (Bradash), 1827(Obrançë) dhe 1841(Lladoc). Pavarësisht se këto vota janë pohuar nga

familjarë dhe numër i konsiderueshëm i tyre edhe verifikuar natën e zgjedhjeve nga ekipet përkatëse në vendvotime dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e tyre e pashpjegueshme. Kjo gjendje ngre dyshime të bazuara se ka pasur mos regjistrim, humbje ose trajtim të pasaktë të këtyre fletëvotimeve, çka përbën shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit dhe të parimeve themelore të procesit zgjedhor. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, çdo qytetar me të drejtë vote duhet të ketë mundësinë që vota e tij të pranohet, të numërohet dhe të reflektohet në rezultatin përfundimtar. Mos regjistrimi ose zhdukja e disa votave votave bie ndesh me nenin 4 të Ligjit, i cili garanton barazinë e votës dhe respektimin e vullnetit të qytetarëve, standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme, të sanksionuara edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. I njëjti thekson se kjo parregullsi, përveçse cenon të drejtën e qytetarëve për të votuar, dëmton drejtpërdrejt rezultatin zgjedhor duke ndikuar direkt në mandatin tim dhe në përfaqësimin real të vullnetit të zgjedhësve dhe kërkojnë nga PZAP-i që të urdhërojë verifikimin e plotë të procesit të pranimit, ruajtjes dhe numërimit të votave nga qendrat e votimit për Komunën e Podujevës, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të mos pasqyrimit të rreth: 25 votave në kutinë 1812/02(Bradash), 4 votave në kutinë 1812/01(Bradash), 3 votave në kutinë 1812/03(Bradash), 3 votave në kutinë 1827/01 (Obrançë) dhe 4 votave në kutinë 1841(Lladoc), të kërkojë sqarim zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi trajtimin e këtyre fletëvotimeve dhe të bëjë rinumërimin e tyre.

KQZ-në përgjigjen në ankesë thekson se KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr, 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr-.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veganta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNRJ ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEI(KZ në komunën e Podujevës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 17.10.2025, ditën e premte, në ora 16:00, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 24.10.2025. Pra nuk është brenda

afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QIN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. (Shih përgjigjen e KICZ në Podujevë).

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit,

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë. Gjithashtu KQZ njofton PZAP se, me datën 22.10.2025, në orën 20:30, ka përfunduar procesi i administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- ***Ankesa është e pasafatshme.***

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Lorik Rashiti, kandidat për Kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë me të cilën ka pretenduar për parregullsi të evidentuar gjatë procesit të numërimit të votave në QKN-Podujevë si dhe pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në QKN-Podujevë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave nuk figurojnë në vendvotimet përkatëse, është e parashtruar pas afatit të paraparë ligjor.

Dispozitat e nenit 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*. Ndërsa në nenin 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“Personi mund të paraqesë ankese në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”*. Po ashtu në nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 24.10.2025, ku ka pretenduar për parregullsi të evidentuar gjatë procesit të numërimit të votave në QKN-Podujevë si dhe pas përfundimit të procesit të numërimit të

votave në QKN-Podujevë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave nuk figurojnë në vendvotimet përkatëse, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Podujevës, *është përmbysur me datën 17.10.2025*, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe e njëjta u deshtë që të hedhet si e pasafatshme.

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 24.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë gjatë numërimit të QKN, i cili ka përfunduar më datë 17.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.342/2025 datë 27.10.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.